



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKE NATYRORE

Rr. Eqrem Çabej, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381-38-249-873 • E-mail: fshmn@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

FSHMN

Ref. nr. 5077 Prishtinë, Dt. 25.09.2023

RAPORT VLERËSIMI TË DORËSHKRIMIT TË PUNIMIT TE DIPLOMES MASTER

FAKULTETI	FSHMN
Departamenti/ Programi	Departamenti i Kimisë (Programi: Kimia Organike)
Projektpropozimi	"Sinteza e [(pirimidin-2-ilimino)-etil]-koromen-2-oneve të zëvendësuara dhe e tiazolidinoneve analoge dhe aktiviteti antikoagulant i tyre". "Synthesis substituted [(pyrimidin-2-ylimino)-ethyl]-choromen-2-ones and analogue thiazolidinones and their antikoagulant activity".
Kandidati	Florentinë Krasniqi
Mentori	Prof. Dr. Ramiz Hoti
Aprovimi i projekt propozimit në Këshillin e Fakultetit	Datë: 28. 04. 2023 Vendimi nr.: 1877
Vlerësimi i dorëshkrimit	<p>Lënda : Raport recensues për vlerësim të dorëshkrimit të temës së masteit</p> <p>Këshilli i FSHMN-së i Universitetit të Prishtinës, në seancën e 55^{te} të rregullt të mbajtur më 27. 04. 2023, (vendimi Nr. 1877) ka aprovuar projekt-propozimin për temë diplome të masterit me titull: "Sinteza e [(pirimidin-2-ilimino)-etil]-koromen-2-oneve të zëvendësuara dhe e tiazolidinoneve analoge dhe aktiviteti antikoagulant i tyre", të kandidatës Florentinë Krasniqi, ka formuar komisionin vlerësues në përbërje</p> <ol style="list-style-type: none">1. Prof. Dr. Ramiz Hoti, kryetar2. Prof. Asoc. Dr. Hamit Ismaili, anëtar3. Prof. Ass. Dr. Ilir Mazreku, anëtar <p>ndërsa për mentor është caktuar Prof. Dr. Ramiz Hoti.</p>

Pas kërkesës së kandidatës për vlerësimin e dorëshkrimit, Komisioni vlerësues ka analizuar dorëshkrimin e kandidatës. Pas shqyrtimit të dorëshkrimit, kemi nderin që Këshillit të Fakultetit të Shkencave Matematike-Natyrore t'i paraqesim këtë:

RAPORT

Të dhënat e përgjithshme

Punimi i diplomës së masterit me titull: "Sinteza e [(pirimidin-2-ilimino)-etil]-koromen-2-oneve të zëvendësuara dhe e tiazolidinoneve analoge dhe aktiviteti antikoagulant i tyre".

, i kandidatës **Florentinë Krasniqi** master i kimisë, është shkruar në 52 faqe tekst me rrallim normal, që së bashku me shtojcën përbëjnë 62 faqe. Dorëshkrimi përfshinë Hyrjen, abstraktin në shqip dhe anglisht, pjesën teorike, metodat dhe materialet, rezultatet dhe diskutimin, përfundimin në shqip dhe anglisht, literaturën e cila përmbanë 38 të dhëna bibliografike të kohëve të fundit, biografinë dhe shtojcën ku janë bashkangjitur spektrat e komponimeve të sintetizuara.

Ky dorëshkrim përmban 17 skema të reaksioneve, 2 tabela dhe shtojcën me spektrat IK.

Analiza e dorëshkrimit

Fillimisht autorja ka paraqitur një hyrje të shkurtër dhe qëllimin e këtij punimi, ku janë paraqitur arsyetimet për përcaktim në këtë fushë hulumtuese.

Në kapitullin e parë (pjesa teorike) autorja është përqendruar në prezantimin e publikimeve të kohëve të fundit nga lëmia e ngushtë të derivateve të zëvendësuara të kumarinës, klasifikimin e tyre, metodat e sintezave të këtyre derivateve dhe aktivitetet e tyre biologjike, me theks të veçantë veprimet e tyre farmakologjike.

Në kapitullin e dytë, janë përshkruar metodat dhe materialet dhe në mënyrë detale janë përshkruar procedurat eksperimentale të cilat janë aplikuar gjatë këtij hulumtimi. Në këtë kapitull janë përshkruar metodat e sintezës, mjetet e përdorura dhe procedurat e sintezave të realizuara me reaksione karakteristike të kondensimit të 3-acetil-4-hidroksikumarinës me aminopirimidine të zëvendësuara. Gjithashtu janë përshkruar edhe reaksionet e ciklizimit të komponimeve të sintetizuara me acid 2-merkaptopropionik. Në këtë kapitull janë përfshirë sintezat e derivateve të zëvendësuara të komponimeve heterociklike [(pirimidin-2-ilimino)-etil]-koromen-2-oneve të zëvendësuara dhe e tiazolidinoneve analoge të tyre:

- 3-acetil-4-hidroksikumarina
- 3-[1-(4-metilpirimidinë-2-ilimino)-etil]-4-hidroksikromen-2-oni
- 3-[1-(4-hidroksi-6-metilpirimidinë-2-ilimino)-etil]-4-hidroksikromen-2-oni
- 3-[1-(4,6-dihidroksipirimidinë-2-ilimino)-etil]-4-hidroksikromen-2-oni
- 3-[1-(4-klor-6-metilpirimidinë-2-ilimino)-etil]-4-hidroksikromen-2-oni
- 3-(4-metilpirimidinë-2-il)-(4-hidroksi-2-okso-2H-kromen-3-il)-2,5-dimetiltiazolidin-4-oni
- 3-(4-hidroksi-6-metilpirimidinë-2-il)-(4-hidroksi-2-okso-2H-kromen-3-il)-2,5-dimetiltiazolidin-4-oni
- 3-(4,6-dihidroksipirimidinë-2-il)-(4-hidroksi-2-okso-2H-kromen-3-il)-2,5-dimetiltiazolidin-4-oni
- 3-(4-klor-6-metilpirimidinë-2-il)-(4-hidroksi-2-okso-2H-kromen-3-il)-2,5-dimetiltiazolidin-4-oni

Në kapitullin e tretë (rezultatet dhe diskutimi) janë diskutuar rezultatet e fituara, duke i argumentuar në bazë të të dhënave spektrale të komponimeve të sintetizuara nga spektrat IK dhe dhe në bazë të të dhënave tjera kimike e fizike. Në këtë kapitull gjithashtu është përshkruar hulumtimi i aktivitetit antikoagulant i komponimeve të sintetizuara duke i aplikuar në sorte të caktuara të minjëve.

Në fund është dhënë përfundimi në shqip dhe anglisht, ku janë përmbledhur rezultatet e arritura gjatë këtij hulumtimi, biografia e kandidatit, literatura ku janë përfshirë 38 të dhëna bibliografike të viteve të fundit nga kjo lëmë, ndërsa në shtojcë janë bashkangjitur spektrat IK të komponimeve të sintetizuara.




Vlerësim dhe propozim

Punimi i diplomës së masterit me titull: **“Sinteza e [(pirimidin-2-ilimino)-etil]-koromen-2-oneve të zëvendësuara dhe e tiazolidinoneve analoge dhe aktiviteti antikoagulant i tyre”**, i kandidatës Florentinë Krasniqi paraqet një kontribut për shkencën e kimisë organike sintetike në aspektin fundamental, e poashtu krijon një bazë solide që këto rezultate të gjejnë aplikim edhe në shkencat mjekësore e farmaceutike. Rezultatet e këtij hulumtimi janë origjinale dhe punimi është i shkruar në mbështetje të normave për organizimin e punimit shkencor dhe si i tillë i përmbushë të gjitha kriteret shkencore.

Në saje të fakteve të lartëshënuara mund të konkludojmë që kandidatja Florentinë Krasniqi, gjatë këtij hulumtimi shkencor ka bërë një punë të çmueshme dhe serioze. Ky punim paraqet një kontribut shkencor në aspektin fundamental nga lëmi i sintezave të komponimeve heterociklike të [(pirimidin-2-ilimino)-etil]-koromen-2-oneve të zëvendësuara dhe e tiazolidinoneve analoge dhe krijon një bazë solide për hulumtime të mëtutjeshme dhe për aplikim praktik të këtyre rezultateve. Të gjitha sygjerimet dhe vërejtjet e dhëna, me seriozitet janë akceptuar nga autorja.

Në bazë të kësaj i propozojmë Këshillit të FSHMN-së të Universitetit të Prishtinës që punimin **“Sinteza e [(pirimidin-2-ilimino)-etil]-koromen-2-oneve të zëvendësuara dhe e tiazolidinoneve analoge dhe aktiviteti antikoagulant i tyre”**, të kandidatës Florentinë Krasniqi, t’u pranojë si bazë për arritjen e titullit shkencor master i shkencave të kimisë dhe ta përcjellë në procedurë të mëtutjeshme.

Anëtarët e komisionit:

1. Prof. asoc. Dr. Hamit Ismajli kryetar

2. Prof. Dr. Ramiz Hoti, anëtar (mentor)

3. Prof. Ass. Dr. Ilir Mazreku, anëtar


Prishtinë, 25. 09. 2023